



## **Thirrje për aplikim për regjistrim në programin e doktoratës në “*Shkenca Sociale dhe të Sjelljes*”, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2023-2024**

Programi i studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “*Shkenca Sociale dhe të Sjelljes*”, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është program i riorganizuar i Doktoratës në “Shkenca Sociale” me Urdhër nr. 111, datë 04/03/2022.

Ky program bazohet mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor.

### **AFATI I APLIKIMIT 04 DHJETOR 2023 – 15 DHJETOR 2023**

#### **KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMIN E STUDIMIT**

Aplikanti duhet:

- Të ketë fituar diplomën ‘Master i shkencave’ ose “Master i Arteve”, apo diplomë të barasvlershme të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente, në fushë të njëjtë ose të përafërt me studimet e doktoratës;
- Të ketë njohje të gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht) në nivelin B2, vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se 2 vjet nga koha e lëshimit të tyre. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- Të ketë notë mesatare të përgjithshme në ciklin më të lartë të studimeve 8 e lart, e llogaritur në bazë të grup-lëndëve karakterizuese të programit të studimit.
- Të jetë personel akademik i Universitetit Europian të Tiranës, ose personel akademik në një Institucion tjetër të Arsimit të Lartë, ose personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
- Të marrë përsipër përbushjen e standardeve shkencore, akademike, ligjore dhe etike.
- Aplikanti duhet të hartojë një Projekt Propozim bazuar në fushat e detajuara të programit të doktoratës dhe projektit kërkimor të drejtuesit të grupit, preferuar nga ai për udhëheqje.

**Projekti kërkimor - shkencor dhe i zhvillimit**  
**Sjellja e individit dhe aktorëve ekonomik në raport me shtetin dhe shoqërinë.**

Nënfusha	Personeli akademik	Titulli akademik	Titulli i projektit kërkimor	Kuota
ISCED Code 0311 <b>Ekonomiks</b> (Ekonometri, Histori ekonomike, Ekonomiks, Ekonomi ndërkombetare, Makro ekonomi, Politikë ekonomike. Buxheti kombëtar)	Selami Xhepa	Prof. Asoc.Dr.	Konkurrenca dhe struktura e tregut: Sa kompetitive janë bërë tregjet vendase.	1
	Hysen Muceku	Prof. Dr.	Përfshirja financiare dhe sektori real: potenciale për përmirësime të eficiencës dhe rritjes ekonomike.	1
	Anilda Bozdo	Prof. Dr	Domosdoshmëria dhe ndërgjegjësimi për rolin e veprimit të një konkurrence të shëndoshë në sistemin bankar	2
	Kreshnik Bello	Prof. Dr	Marketingu përballë horizontit teknologjik dhe konsumatorëve kreativë	2
ISCED Code 0312 <b>Shkenca politike dhe edukim qytetar</b> (Edukim qytetar; Të drejtat e njeriut; Marrëdhënie ndërkombetare; Studime të paqes dhe konflikteve; Histori Politike; Shkenca Politike; Politikat publike)	Ferit Duka	Prof. Dr.	Shteti, e drejta dhe shoqëria në trojet shqiptare gjatë shekujve.	2
	Nevila Nika	Prof. Dr.	Tiparet e Institucioneve politiko- juridike në shtetin shqiptar.	2
	Blendi	Lami	Ndikimi i krizave të sotme globale në ripozicionimin gjeopolitik të vendeve të Ballkanit Perëndimor	2
	Agron Cuka	Prof. Dr.	Roli i lëvizjes dhe ushqyerjes në stilin e jetesës.	2
	Adrian Papajani	Prof. Dr.	Roli i historisë në edukimin demokratik/qytetar	2
	Edi Puka	Prof.Dr.	Edukimi qytetar, politikat dhe strategjitë arsimore në arsimin parauniversitar.	2

Nënfusha	Personeli akademik	Titulli akademik	Titulli i projektit kërkimor	Kuota
	Tomi Treska	Prof. Asoc.Dr.	Politika, reforma dhe aktorët në sistemin e arsimit parauniversitar shqiptar.	1
ISCED Code 0313 <b>Psikologji</b> (Shkenca konjitive, Psikoanalizë, Psikologji, Psikoterapi)	Voltisa Lama	Prof. Asoc.Dr.	Shëndeti mendor i fëmijëve.	1
	Drita Kruja	Prof. Dr.	Psikologjia e Marketingut dhe Sjellja Konsumatore	2
	Erika Melonashi	Prof. Asoc.Dr.	Eksplorimi i determinantëve social-kulturorë të shëndetit fizik dhe mendor	1
	Admir Jance	Prof. Asoc.Dr.	Aplikimi i Parimeve të Biologjisë në Studimin e Proceseve Mendore dhe Sjelljes	2
ISCED Code 0314 <b>Sociologji dhe studime kulturore</b> (Kriminologji; Gjeografi kulturore; Studime kulturore; Demografi; Etnologji; Studime gjinore; Gjeografia humane; Kulturat rajonale; Antropologjia sociale; Teorite e konflikteve sociale; Sociologji)	Belina Budini	Prof. Asoc.Dr.	Praktikat e komunikimit në media: Aktorë, Institucione, Kulturë.	1
	Shefqet Muçi	Prof. Asoc.Dr.	Karakterit parandalues i dënimit penal.	1
	Juelda Lamce	Prof. Asoc.Dr.	Marrëdhëniet familjare mes traditës dhe zhvillimeve të reja në shoqërinë multikulturore.	1
	Edith Mihali	Prof. Asoc.	Tradita dhe zhvillimi i komunikimit muzikor	2
	Shqipe Zani	Prof.	Krijimtaria vokale ne fizionomine e kultures kombetare	2
	Ramazan Peku	Prof. Asoc.	Ndikimi i politikave kulturore ne artin shqiptar	2
	Piro Misso	Prof.	Formacionet muzikore qytetare te zonave Jug-Lindore shqiptare	2
	Bujar Kapexhiu	Prof.	Komunikimi pamor në Arte, Kulturë dhe Politikë.	1
	Elida Miraj	Prof. Dr.	Dinamikat e planifikimit urban dhe arkitekturës	1



## DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM

Aplikantët duhet të dorëzojnë pranë Koordinatorës së zyrës Doktorale, zyra 406B dosjen me dokumentacionin e kërkuar duke filluar nga data **04.12.2023** deri në datë **15.12.2023**.

Dosja duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë personale drejtuar Departamentit të Shkencave të Aplikuara, pranë **Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare**, përgjegjës për organizimin dhe administrimin e studimeve të ciklit të tretë;
2. CV personale dhe një listë e punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së aplikimit (në rastin kur personi që aplikon ka të tilla);
3. Kopje të noterizuara të diplomës universitare, kopje të noterizuar të diplomës “Master i shkencave” (ose të një diplomë ekuivalente me të si “DND”), si dhe kopje të noterizuar të listës së notave për të gjitha nivelet e studimeve/diplomave.
4. Fotokopje e ID ose pasaportës;
5. Dy fotografi;
6. Dy rekomandime nga persona me titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”;
7. Një propozim kërkimi në të cilin përcaktohet dhe emri i udhëheqësit shkencor (template bashkëlidhur) ;
8. Kandidati duhet të dorëzojë dëshmi origjinale ose të noterizuar të njohjes së gjuhës së huaj.

Aplikimet që nuk përmbajnë dokumentet e sipërpërmendura nuk merren në konsideratë.